



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:006722

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05705588

KF.nr.122/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “MAXBET” NTP me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Blerim Prestreshi, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 75,523.05 € në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit së autorizuar të paditësit Avokat Blerim Prestreshi, dhe në prani të autorizuarit të palës së paditur A.A., me datë 30.04.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “MAXBET” NTP me seli në Graçanicë.
- II. ANULOHET PJESËRISHT vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.502/2019 i datës 17.12.2019, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet Tatimit në Fitim dhe Kontributet Pensionale për periudhën Mars/2016 - 2019 në shumë prej 60,418.44 €, dhe në emër te ndëshkimit 25% shumën prej 15.104.61 €, e të gjitha këto në shumë totale prej 75,523.05 €.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “MAXBET” NTP me seli në Graçanicë t’ia kthej mjetet e paguara më tepër dhe atë për Tatimin në Fitim dhe Kontributet Pensionale për periudhë Mars/2016-2019 shumën prej 60,418.44 €, dhe në emër te ndëshkimit 25 % në këtë vlerë, shumën prej 15.104.61 €, e të gjitha këto në shumë totale prej 75,523.05 € së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në afat prej 15 ditësh nga

plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Po ashtu DETYROHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin “MAXBET” NTP me seli në Graçanicë ta liroj edhe nga interesat e kalkuluara në këto shuma si më lartë.

IV. MBETËT NË FUQI Vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.502/2019 i datës 17.12.2019, në pjesës jo kontestuese përtej shumave të gjykuara si më lartë, edhe atë për tatimin në fitim shumë prej 10,551.36 euro, për kontributet pensionale shumë prej 3,356.87 euro, sipas Raportit të Kontrollës të datës 03.10.2019, të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe të vërtetuar me vendimin nr.502/2019 i datës 17.12.2019.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.502//2019 i datës 17.12.2019. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 30.04.2024 dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse deklaroi se: mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë. Kemi pranuar ekspertizën financiarë të përpiluar nga eksperti financiar A.H., ndaj te njëjtës nuk kemi vërejtje, pasi që konsiderojmë se eksperti është bazuar dhe ka konstatuar jo vetëm hyrjet të cilat i ka llogaritur ATK-ja por edhe daljet, respektivisht fitimet të cilat i kanë realizuar pjesëmarrësit e lojërave të fatit. Tutje ka shtuar se një ndër kushtet sipas ligjit për lojërat e fatit që një subjekt që merret me këtë aktivitet të licencohet ka qenë edhe dhënia e qasjes ATK-ës, në programin e subjektivit-tatimpaguesit, e në të cilin qartë identifikohen tiketa hyrëse dhe dalëse. E në të cilin program ATK-ja ka pasur qasje të vazhdueshme. Duke pasur parasysh se kjo kontroll është bërë në kohën kur është shfuqizuar ligji për lojërat e fatit, e paditura nuk ka lejuar kthimin e depozitës për licence duke e ngarkuar tatimpaguesin me këtë tatim shtese i cili është objekt i kësaj padie. Prandaj eksperti financiar ka bërë krahasimin e kontrollit të vitit 2015, ku ATK-ja ka pasur qasje në programin e tatim paguesit dhe ka nxjerre të dhëna të cilat janë shënuar në atë raport të kontrollit. Në raportin e kontrollit të vitit 2019 nuk është dhënë asnjë koment se për çfarë arsye ATK-ja nuk e ka përdorur kodin i cili i është dhënë në momentin e licencimit për tu qasur në programin e tatimpaguesit në të cilin kanë qenë të evidentuara si hyrjet ashtu edhe daljet. Sipas këtij konstatimi të inspektoreve tatimor çuditërisht rezulton se tatimpaguesi nuk ka pasur asnjë dalje, për faktin sepse të njëjtit nuk kanë qenë në gjendje të i verifikojnë daljet. Pra në këtë raport

nuk thuhet se tatim paguesi nuk i ka lajmëruar dallimin ne mes te tiketave hyrëse dhe dalëse, por se ATK-ja nuk ka qenë në gjendje të i verifikojë. Andaj mbi këtë bazë dhe në gjetjet e konstatuara dhe të precizuara në këtë seancë nga eksperti financiar bëje precizimin e kërkesëpadisë si në vijim “1.Aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit si e bazuar, 2.Anulohet pjesërisht vendimi i te paditurës me nr. te protokollit 502/2019 dhe atë vetëm për shumën e tatimit te paguar më tepër, 3.Mbetet ne fuqi vendimi kontestuese në shumën e tatimit prej 13.908.23€, siç është konstatuar me ekspertizë, 4.Obligohet e paditura që ti a ktheje paditëses shumën e tatimit të paguar më tepër në vlerë prej 60.418.44 €, për tatimin ne fitim dhe kontributet pensionale, shumen prej 15.104.61 € ne emër te ndëshkimit 25 % dhe interesat e aplikuara nga ATK për këtë shume, te gjitha këto me kamat ligjore prej 8 %, ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 20.04.2021, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi, si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i ATK-së nr.502/2019 i datës 17.12.2019 ka mbështetje ligjore dhe faktike dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor të datës 30.04.2024 dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Gjatë vlerësimit tatimor ATK-ja asnjëherë nuk ka kërkuar të dhëna individuale për persona fizik, lidhur me daljet përkatësisht shpërblimet të cilat pala paditës pretendon edhe për kundër që nuk janë askund te specifikuara ne ligj, dorëzimi i këtyre të dhënave për ATK-ën. Gjatë tërë kontrollit ATK ka kërkuar dorëzimin provave përkatësisht dëshmimeve të këtyre daljeve, e të cilat ashtu siç ceket në raportin e kontrollit paditësi asnjëherë nuk i ka ofruar. Pretendimi i paditësit se ATK ka pasur qasje në këto të dhëna nuk e justifikon paditësin që ka qenë i obliguar te mbaje librat dhe regjistrimet sipas dispozitave që i paraqit ne fillim te këtij shqyrtimi gjyqësor. Qasja e ATK-së në këto të dhëna ka pasur vetëm për qëllim te vizitave te cilat kane mundur te behën tek paditësi por askund ne legjislacionin tatimor nuk thuhet se ATK ka qenë e obliguar ti marre dhe ruaj këto shënime dhe për më tepër nuk kemi asnjë prove te prezantuar deri më tani që ATK i ka marre këto shënime, për me tepër ky pretendim i paditësit është kontradiktor për faktin se në padi thekson se këto shënime ruhen vetëm për periudhën 6 mujore, atëherë si është mundur që ATK te qaset dhe ti nxjerr shënimet e tilla. Lidhur me deklaramet e ekspertit në pyetjet e parashtruara konsiderojmë se ka kontradikta te mëdha në mes te asaj që deklaron dhe paraqitjes si në ekspertize. Duhet cekur se as eksperti nuk mundi ta konstatoj apo nuk desh i të deklarohet se këto prova ishin apo nuk ishin te elaboruara në raport te kontrollit por është fakt se këto prova nuk kane qene te elaboruara dhe kjo shihet edhe në

pretendimet me shkrim që i ka paraqitur paditësi. Është e pa pranueshme fakti se si mund të ndërtohet një ekspertizë financiar nga provat ofruara ne formatin Exel, ashtu siç u deklarua vetë eksperti dhe të siguruara nga paditësi, e te cilat prova janë shume lehtë të ndryshueshme. Vetë eksperti në pyetjen tonë theksoje se tatim pagues paditësi ka qene i obliguar që te i ruaj këto kopje te kuponëve në librat e tij kontabël. Por që realisht edhe vet gjate përpilimit te ekspertizës financiare nuk i ka poseduar. Andaj kërkojmë nga gjykata që në rastin e marrjes se vendimit mos ti fal besimin ekspertizës financiarë sepse është bazuar në prova të pa pranueshme. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoje si te pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestuese. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi 502/2019 i datës 17.12.2019, raporti i kontrollit i datës 03.10.2019, deklaratat e hyrje-daljeve ne formë tabelare me te dhëna përkatëse, faqja e aplikacionit në sistem, përgjigja ne padi e datës 20.04.2021, pasqyra e tatimpaguesit së bashku me gjendjen e borxheve e datës 13.04.2021, ankesa e ushtruar në ATK, ekspertiza financiare e datës 26.02.2024, dhe raporti i kontrollit i datës 12.06.2015.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raportit të kontrollit të datës 30.10.2019, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se subjekti “MAXBET” NTP me seli në Graçanicë, nga e paditura ATK-ë i është nënshtruar kontrollit ku objekt i kontrollit kanë qenë TVSH 01/2016-04/2019, PD 2016-2018, CI 01/2016-04/2019, WM 01/2016-04/2019, CM 01/2016-04/2019, WR 01/2016-04-2019. Po ashtu, nuk është kontestuese as fakti se subjekti në procedurë ka ushtruar ankesë pranë Departamenti të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 17.12.2019 ka marrë vendimin nr.502/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë

të dytë, me të cilin e ka refuzuar si të bazuar ankesën e tatimpaguesit, dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë dhe ndëshkimet të caktuara me kontroll i ka konfirmuar si të bazuar, e kundër të cilit vendimi paditësi me padinë e datës 20.01.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar si të pa bazë ankesën e subjektit tatimor këtu paditësit, dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë dhe ndëshkimet të caktuara me kontroll i ka konfirmuar si të bazuara me arsyetim se tatimpaguesit gjatë procedurës së kontrollit nuk ka ofruar dokumentacionin e kërkuar, respektivisht tiketat fituese me qëllim të kalkulimit të hyrave sipas nenit 27 paragrafi 1.3 i Udhëzimit Administrativ nr.03/2013. Gjatë periudhës së kontrollit vazhdimisht është kërkuar që të ofroj të njëjtat, por tatimpaguesi nuk i ka ofruar me arsyetim se kanë qenë shumë dhe nuk ka pasur si të i ruaj. Kontrolli ka insistuar të i dërgoj në formë fizike apo në mënyrë elektronike, por tatimpaguesi ka deklaruar se sistemi i tyre i ruan vetëm 6 muaj dhe pastaj fshihe. Në këtë rast tatimpaguesi ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1, neni 57 paragrafi 1.1 i Ligjit nr.05/L-037 dhe neni 17 paragrafi 11 i Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. Sipas të cilave dispozita çdo person që ka të drejtën dhe obligimin e imponuar nga ky ligj, duhet të sigurohet që të ruhen kopjet e faturave, fatura të thjeshtësuara, kuponëve dhe dokumenteve që shërbejnë si fatura, të lëshuara nga veti ai ose nga klienti, si dhe të gjitha librat dhe regjistrimet, dokumentet dëshmuese të ruhen për periudhën së paku 6 vitesh. Prandaj, kontrolli në mungesë të dëshmive të tiketave fituese e ka pas të pamundur të bëjë verifikimin e tyre dhe të njëjtat i ka trajtuar në tërësi si shitje. Tutje ka shtuar se pretendimi i tatimpaguesit se ka angazhuar ekspert dhe ka rikthyer shënime dhe dëshmitë e tiketave fituese janë në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 8 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat e cila parasheh se “Çdo dokument i ofruar jashtë afatit të paraparë në paragrafin 7 të këtij neni, nuk do të merret në shqyrtim nga divizioni i Ankesave në çdo ankesë të mëvonshme të paraqitur nga tatimpaguesi, nëse dokumenti ka qenë ekzistues në momentin e lindjes së kontestit...”. Divizioni i ankesave ka konstatuar se këto evidenca janë kërkuar në vazhdimësi nga kontrolli nga muaji 06/2019 deri në përfundim të kontrollit në muajin 09/2019 dhe i njëjti nuk i ka ofruar dhe nuk ka bërë përpjekje që me ndihëm e ekspertëve t'i rikthej shënimet e kërkuara me kohë.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të

autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.122/22 të datës 24.01.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar A.H. me detyrat përkatëse sikurse në dispozitiv.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 26.02.2024 dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 30.04.2024, për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi se: Gjatë verifikimit dhe analizimit duke i regjistruar të hyrat dhe daljet e padeklaruar, atëherë eksperti financiar konstaton se në vitin 2016 ka një qarkullim shtesë në shumë prej 3,453,03 €, ku TVSH për këtë shumë është 621.55 €, ndërsa Tatimi në Fitim është 345.30 €. Për periudhën 2016 deri në mars të vitit 2019, tatimpaguesi ka realizuar një qarkullim prej 1,117.757.79 €. Mirëpo gjatë kësaj periudhe ka pasur dalje, fitimet e palëve që kanë realizuar nga bastet e vendosura është në shumë prej 870,527.02 € dhe po ashti gjatë kësaj periudhe si blerje-shpenzimet ka pasur prej 141,717.16 €. Nga të gjitha këto rregullime tatimpaguesi –biznesi “MAXBET” ka realizuar një fitim para tatimi në shumë prej 105, 513.61€. Të gjitha këto, janë siguruar nga deklaratimet dhe librat e shitjes dhe të blerjes që tatimpaguesi ka mbajtur gjatë periudhës 2016-mars 2019. Duhet të theksohet si qarkullim ashtu dhe blerjet-shpenzimet nuk ndryshojnë sa i përket deklaratimeve të tatimpaguesit në raport me kontrollin e ATK-së sipas raportit të kontrollit. Ndryshim i i vetëm është që në raportin e ATK-së nuk janë llogaritur daljet, pra nuk janë marr parasysh daljet po fitimet që qytetarët kanë realizuar gjatë vendosjes së basteve dhe të cilat tatimpaguesi biznesi “MAXBET” i ka regjistruar si dalje. Duke llogaritur tatimin në fitimin e realizuar për periudhën 2016-mars 2019 i cili fitim para tatimit është në shumë prej 105, 513.61 € në këtë fitim llogaritet 10% e tatimi që është në shumë prej 10,513.61 €. Pas llogaritjes së ndëshkimeve prej 25 % atëherë ndëshkime kemi në shumë prej 2,637.84 €. Totali i tatimi bashkë me ndëshkime është në shumë prej 13, 189.20 €. Kontributi Pensional është llogaritje në shumë prej 3,356.87 €. Në këtë shumë është llogaritur ndëshkimi prej 25% atëherë ndëshkimi është në vlerë prej 839.22 €. Totali i kontributit bashkë me ndëshkime është në shumë prej 4,196.08 €. Totali i Tatimit dhe kontributit bashkë me ndëshkime është në shumë prej 17,385.28 € për periudhën 2016 deri në mars 2019.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 26.02.2024 të ekspertit A.H. në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 30.04.2024 ka deklaruar se: qëndroj pranë ekspertizës se punuar në këtë lëndë, në bazë të dhënave të siguruar nga tatimpaguesi e që sipas ATK-ës nuk janë njohur daljet, ku sipas ligjit për lojërat e fatit 04/L-080, neni 70 pika 2.11, “ organizatori, anëtarët e tij , partneret , punonjësit dhe personat e tjerë që punojnë për organizatorin janë të obliguara të mbajnë fshehtësinë e pjesëmarrësve dhe pjesëmarrjen e tyre në lojë”, pra sipas kësaj i bie që një fitues vetëm dorëzon tiketën tek organizatori dhe pranon të holla-fitimin. Gjate ekspertizës jam bazuar edhe sipas raportit të kontrollit të vitit 2015 të vetë ATK-ës e i cili raport kontrolli mban datën 12.06.2015, i bashkangjitur ekspertizës ku sipas këtij raporti këtu paditësit i janë pranuar të gjitha daljet, ku sipas ekspertit diferenca në qarkullim për periudhën kontestuese të kontrollit është në vlera prej 105.513.61 €, tatimi 10 % në këtë shumë është vlera prej 10.551.36 €, ndëshkimet 25 %, 2.637.84 €, shtuar edhe kontribute pensionale për këtë periudhë e të cilat janë në vlerën prej 3.356.87 € ndëshkimet prej 25 % në këtë shumë janë 839.22 €, e ku totali i obligimeve me ndëshkime nga ana e tatim paguesit ndaj ATK-ës sipas eksperti janë 17.385.28 €. Daljet e deklaruara nga tatim paguesi janë të evidentuar në librat e shitjes së tatim paguesit dhe këto libra janë të çastshme për të gjithë përfshirë edhe ATK-ën.

Gjykata ka gjetur se ATK-ë vendimin e saj e arsyeton duke theksuar se bazuar në analizën e raportit të kontrollit dhe shkresave në dosje të tatimpaguesit konstatohet se tatimpaguesi gjatë procedurës së kontrollit nuk ia ofruar dokumentacionin e kërkuar, respektivisht tiketat fituese me qëllim të kalkulimit të hyrave sipas nenit 27 para.1.3 të udhëzimit Administrativ nr.03/2013, por ATK-ë ka injoruar provat e ofruara nga paditësi për arsye se paditësi i ka sqaruar ATK-së se kur paditësi është licencuar për lojërat e fatit-bastet sportive, si njëra nga kushtet që është dashur të plotësohen për licencim, ka qenë krijimi i mundësisë që ATK-ë të ketë qasje në programimin elektronik për baste sportive. Tatimpaguesi në programin e tij elektronik ka mbajtur të regjistruar të gjitha të dhënat e hyrjeve dhe daljeve, pra fitimet dhe humbjet e po ashtu ka regjistruar pra edhe sa para u ka dhënë klientëve të cilat kanë fituar në këto baste sportive. Tatimpaguesi në përputhje me paragrafin 1.3 të nenit 27 dhe aneksin-4 të UA nr.3/2013 për zbatimin e ligjit për lojërat e fatit i a mbajtur librat dhe regjistrimet.

Tutje gjykata ka konstatuar se në raportin e kontrollit të ATK-së nuk janë marr parasysh daljet apo fitimet që qytetarët kanë realizuar gjatë vendosjes së basteve dhe të cilat tatimpaguesi-biznesi “MAXBET” ka regjistruar si dalje, pra nga raporti i kontrollit shihet se si të hyra kanë marr shumën totale të tiketave të shitura, që do të thotë se janë paraqitur vetëm hyrjet dhe jo daljet.

Ku sipas Ligjit nr.04/L-080 për Lojërat e Fatit, Basti Sportiv neni 70 pika 2.11 organizatori, anëtarët e tij, partnerët, punonjësit dhe personat tjerë që punojnë në për organizatorin, janë të obliguar të mbajnë fshehtësinë e pjesëmarrësve dhe pjesëmarrjen e tyre në lojërat e fatit.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore, për t'ia kthyer paditësit shumat e mjetet e paguara me tepër dhe atë Tatimit në Fitim dhe Kontributet Pensionale për periudhë Mars/2016 - 2019 në shumë prej 60,418.44 €, ne emër të ndëshkimit 25 % shumën prej 15.104.61 €, në shumë totale prej 75,523.05 €, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Gjkata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi pjesërisht vendimin e kontestuar, duke e obliguar të paditurën që paditësit të ia kthej shumat e paguar më tepër në shumë totale prej 75,523.05 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. “Gjkata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”, paragrafi 2. “Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”. Paragrafi 3. “Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”, paragrafi 4. “Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykim i zëvendëson aktin e anuluar”, dhe paragrafi 5. “Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”.

Gjkata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi prej 60,418.44€, në emër të tatimeve shtesë për periudhën kontestuese mars/2016 – 2019, dhe shuma prej 15,104.61€ në emër të ndëshkimeve, si pasojë e ri-vlerësimeve tatimore nga e paditura u konstatua nga ekspertiza

financiare e datës 26.02.2024, dhe sqarimeve plotësuese të ekspertit financiar A.H. si në seancën e datës 30.04.2024.

Në lidhje me kamatën gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit në pajtim me dispozitën e nenit 57.4 të Ligjit nr.2044/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është parashikuar se “Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” dhe dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se “Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t’i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Lidhur me pjesën tjetër përtej këtyre shumave të gjykuara sikurëse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata i ka lënë në fuqi vlerësimet e të paditurës sipas vendimit kontestues nr.502/2019 të datës 17.12.2019, kjo për faktin se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e datës 30.04.2024 në precizimin e kërkesëpadisë ka propozuar që të anulohet pjesërisht vendimi i të paditurës me nr.protokollit 502/2019 dhe atë vetëm për shumën e tatimit të paguar më tepër, tanimë shuma prej 13,908.23 euro përtej shumave të gjykuara si më lartë mbetet jo kontestuese dhe të njëjtën këtu paditësi e ka pranuar sipas vlerësimeve të ATK-së. Pra, në rastin konkret paditësi të njëjtat shuma si më lartë tanimë i ka bërë si jo kontestuese dhe se për të njëjtat ka pranuar edhe të gjeturat nga ekspertiza financiare, andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në elaborim dhe vlerësim të të njëjtave.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.122/22 datë 30.04.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate